



VENDIM

Nr. 83 Datë 13 .09.2011

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME
SHUMICË PËR PËR PERIUDHEN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.78, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.09.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për periudhen e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi :

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit publik me shumicë për periudhen e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI